



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 106

Prishtinë, më 4.4.2024, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rustemi, Driton Selmanaj, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Hydajet Hyseni- Kaloshi, Hajdar Beqa dhe Erxhan Galushi.

Munguan: Besnik Tahiri dhe Blerta Deliu-Kodra.

Mbledhjen e kryesoi Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Liridon Salihi, GLPS; Vullnet Bugaqku, KDI; Edina Avdiu, RTK; Arta Dedinca, KP; Detrina Alishani, KK; Viona Bunjaku, Lëvizja FOL; Natyra Salihaj, Ekonomia Online.

Stafi mbështetës i Komisionit: Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 29.1.2024, 2.2.2024, 29.2.2024;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 08/L-262 për ndryshim plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre;
4. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-034;
5. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur;
6. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 08/L-132 për ekzekutimin e sanksioneve penale;

7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke e shtuar pikën numër 7, me kërkesë të deputetit Visar Korenica, për verifikim të votave të seancës plenare të Kuvendit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 29.1.2024, 2.2.2024, 29.2.2024

Kryetari konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më datë 29.1.2024, 2.2.2024, 29.2.2024, u miratuan.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-262 për ndryshim plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre

Kryetari paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, se Komisioni për Projektligjin nr. 08/L-262 për ndryshim plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre dhe Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, ka paraqitur 1 amendament për këtë projektligj. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Driton Selmanaj, potencoi se është vetëm një amendament dhe i njëjti është krejtësisht teknik, që thotë se fjala “paragrafi 6”, zëvendësohet me fjalën “paragrafin 5” dhe paragrafi i ri numër “7”, zëvendësohet me numrin “6”. Po ashtu, tha se është një mund i madh për një çështje procedurale dhe Komisioni funksional ka pasur mundësi ta trajtojnë edhe nga aspekti përmbajtjesor.

Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se miratohet raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit funksional t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L- 262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin dhe amendamenti i propozuar është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji dhe amendamenti i propozuar mund t’i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-034

Kryetari, tha se tri pikat e radhës janë rrjedhoje e planit të punës së Komisionit për Legjislacion dhe kemi paraparë mbikëqyrjen e zbatimit të tre ligjeve për këtë sesion.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-034.

1. Formohet grupi i punës në përbërje:

Hydajet Hyseni, kryesues,
Adnan Rustemi, anëtar,
Driton Selmanaj, anëtar,
Artan Abrashi, anëtar,
Hajdar Beqa, anëtar, dhe
Besnik Tahiri, anëtar.

- 5. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur**

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur

1. Formohet grupi i punës në përbërje:

Erxhan Galushi, kryesues,
Adnan Rustemi, anëtar,
Arijeta Rexhepi, anëtare,
Blerta Deliu- Kodra, anëtare, dhe
Besnik Tahiri, anëtar.

- 6. Formimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 08/L-132 për ekzekutimin e sanksioneve penale**

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 08/L-132 për ekzekutimin e sanksioneve penale

1. Formohet grupi i punës në përbërje:

Dimal Basha, kryesues,
Adnan Rrustemi, anëtar,
Driton Selmanaj, anëtar,
Artan Abrashi, anëtar,
Hajdar Beqa, anëtar dhe
Besnik Tahiri, anëtar.

7. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Visar Korenica për verifikim të votimit të dy projektligjeve

Kryetari paraqiti për shqyrtim kërkesën e deputetit Visar Korenica për verifikim të votimit të dy projektligjeve. Komisioni për Legjislacion ka pranuar një kërkesë nga deputeti Visar Korenica, anëtar i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, me kërkesë të verifikimit të votimit të dy projektligjeve, me kuorum të pamjaftueshëm. Siç thotë edhe kërkesa e deputetit, në bazë të nenit 76 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe në baze të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 57, pika 6, lidhur me nenin 122, paragrafi 2, parashtroj këtë kërkesë, si më poshtë. Kryetari theksoi se deputeti po pretendon që Projektligji nr.08/L-212 për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor dhe Projektligji për tekstet shkollore, janë miratuar, respektivisht është konstatuar se janë miratuar në lexim të parë, pa kuorum dhe ka kërkuar interpretim nga Komisioni për Legjislacion. Kryetari potencoi se e ka shikuar Rregulloren e Kuvendit dhe ka konstatuar se çështja nuk bie në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion dhe nuk bëhet fjalë për interpretim të Rregullores, nuk bëhet fjalë për ndonjë shkelje të ndonjë të drejte të deputetit, qoftë për të marrë pjesë në debate, replika apo në proceset e votimit. Kryetari shtoi se çështja është krejtësisht teknike në kuptimin e verifikimit të votave në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, në ditën kur janë votuar këto projektligje. Kryetari tha se po të konstatohej se një ligj miratohet me 31 vota për, në një seance plenare ku janë vetëm 60 deputetë, atëherë natyrisht që do të përbënte objekt interpretimi dhe do të thoshim që kërkohen 61, por në rastin konkret, askush nuk po pretendon që në seancë me 60 deputetë konsiderohet seancë me kuorum, por thjesht ka pretendime për numërim të pasaktë të votave të deputetëve dhe ky duhet të jetë një veprim krejtësisht teknik administrativ i Sekretarisë së Kuvendit në komunikim me Kryetarin e Kuvendit, dhe në rastin më të mirë, me Kryesinë e Kuvendit, për të vërtetuar se a kanë qenë 61 deputetë apo 60 deputetë. Kryetari shtoi se mekanizmat për ta kontestuar në kuptimin procedural, në kuptimin e miratimit të një projektligji ekziston, por si Komision për Legjislacion nuk mund të lëshohemi në verifikimin e votave. Si komision, mund të interpretojmë aktet, mund të interpretojmë shkeljet e pretenduara. Kryetari theksoi se ka përgatitur një përgjigje për deputetin Korenica dhe tha se deputeti Visar Korenica pretendon se nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për votimin e Projektligjit për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor në lexim të dytë dhe Projektligji për tekstet shkollore në lexim të parë. Në vijim, shtoi se Komisioni për Legjislacion konstaton se kërkesa e deputetit për ta verifikuar kuorumin nuk bie në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion. Komisioni po ashtu konstaton se nuk kemi të bëjmë me interpretim të Rregullores, sipas nenit 122, ku të drejtat

e deputetit ndërlidhen me të drejtën për të diskutuar dhe replikuar, ndërsa në këtë rast, kërkesa e deputetit nuk ndërlidhet me diskutimin tij, por konteston procesin në kuptimin e numërimit të votave dhe kjo kërkesë nuk bie në përgjegjësi të Komisionit për Legjislacion. Kryetari shtoi se para votimit, Kryetari i Kuvendit e ka përgjegjësi të konstatojë nëse janë plotësuar kushtet për të hyrë në votim, ashtu siç konstaton dhe kumton numrin e votave për, kundër dhe abstenim, për secilin akt që e miraton Kuvendi, dhe në rastin konkret, Kryetari ka konstatuar miratimin e projektligjit, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit. Kryetari theksoi se duke u bazuar në konstatimet e theksuara, Komisioni vlerëson se nuk është në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion, procesi i verifikimit të votimit të deputetëve në seancë plenare. Kryetari tha se e ka drejtuar deputetin Korencia për të parashtruar kërkesë edhe në Kryesi të Kuvendit dhe shtoi se aty është vendi për të diskutuar, nëse ekzistojnë faktet e deputetit për një gjë të tillë.

Driton Selmanaj, tha se do të ishte mirë që kërkesa të shpërndahej më herët, në mënyrë që edhe ne të kishim mundësi ta lexonim kërkesën, por t'i lexojmë edhe dispozitat e Rregullores dhe të vinin deri te përfundimi, që ju keni arritur. Deputeti Selmanaj tha se është një situatë delikate, sepse është e paprecedent dhe nuk beson që ka ndodhur ndonjëherë. Mirëpo, nga ana tjetër, nëse ne ua mbyllim derën deputetëve të ngrenë shqetësime të tilla, atëherë cila është adresa për ta? Më tej shtoi se nuk beson që Kryesia e Kuvendit i jep përgjigje kësaj çështje dhe si komision duhet të kemi një qasje më ndryshe, sepse këtu po flitet për vendimmarrjen, për kuorumin dhe këto janë dispozita të Rregullores që e përcaktojnë, e për ta bërë atë, duhet të shihet prezenca dhe kush do ta bëjë atë, nëse ne nuk e mbështesim kërkesën e deputetit që administrata ta bëjë verifikimin se a ka pasur kuorum apo jo. Deputeti Selmanaj theksoi se si mjet që e ka shfrytëzuar deputeti nuk duhet refuzuar, mirëpo mund të kërkojmë verifikim nga stafi teknik dhe administrata e Kuvendit dhe më pas të interpretojmë nëse ka pasur kuorum në vendimmarrje apo jo. Më tej shtoi se ka përshtypjen që nëse e kthejmë këtë përgjigje, po mbyllim një derë që deputetët kanë të drejtë t'i adresohen, por si rezultat i fajit të mekanizmave të tjerë institucionalë që nuk po arrijnë t'i blejnë pajisjet elektronike të votimit dhe nuk do të vinte në shprehje një kontestim i tillë. Deputeti Selmanaj tha se këtë çështje duhet ta trajtojnë me seriozitet dhe propozoi që ta trajtojnë në mbledhjen e radhës dhe të japin vlerësimin përfundimtar.

Kryetari sqaroi se kërkesën e kemi pranuar pasi e kemi dërguar rendin e ditës dhe thirrjen për këtë mbledhje, por megjithatë është dashur të bashkëpunojmë më shumë me administratën e Komisionit, sepse e kisha në plan që ta propozoj si plotësim të rendit të ditës edhe për shkak të afateve dhe për të vepruar në afat të arsyeshëm, edhe në raport me deputetin, sepse ka procedura që po zhvillohen dhe njëri prej projektligjeve është miratuar në lexim të parë, ndërkohë janë themeluar grupe të punës që e trajtojnë projektligjin nen për nen, dhe në ndërkohë, rrjedhin afatet që parashihen me rregullore. Pra, do të thotë votimi në lexim të dytë dhe nuk mund ta mbajmë peng këtë gjë. Kryetari tha se kuorumi nuk është çështje për interpretim, por është evidentim objektiv faktik dhe nëse do të kishin pyetje se sa duhet të jetë kuorumi minimal i seancës për t'u mbajtur seanca dhe për të filluar votimi, pa asnjë dyshim, ajo do të përbënte objekt interpretimi dhe ne do t'i përgjigjeshim deputetit në kërkesën e tij, por në këtë kërkesë nuk ka një pretendim të tillë, këtu ka pretendim që numërimi i votave është bërë i pasaktë dhe ai veprim është tërësisht teknik dhe objektiv. Kryetari potencoi se deputeti Korencia e ka të drejtë legjitime kërkesën nga Sekretaria e Kuvendit për verifikimin dhe raportin se sa deputetë kanë marrë pjesë në momentin e votimit dhe me atë raport duhet të komunikojë me Kryetarin e Kuvendit, eventualisht me Kryesinë e Kuvendit, për ta adresuar që nuk kanë qenë 61 deputetë, por kanë qenë 60. Kryetari shtoi se në

momentin kur ekziston ky raport i konstatimit se sa deputetë kanë qenë në seance në momentin e votimit, atëherë nuk ka çështje për interpretim dhe tha se këtë kërkesë mund ta bëjë vetë deputeti. Në vijim, theksoi se ekziston vetëm mekanizmi i Gjykatës Kushtetuese për ta kontestuar ligjin në kuptimin e procedurës jo të përmbajtjes. Kryetari tha se ia ka shpjeguar këtë çështje deputetit, por duhet që formalisht t'i kthejmë një përgjigje dhe shtoi se po të shihte ndonjë element që Komisioni mund të kontribuonte brenda mandatit që ka, unë pa hezitim do ta bëja.

Hajdar Beqa, tha se sa i përket kërkesës që na e ka drejtuar deputeti Korenica, ne si Komision shpeshherë kemi dalë jashtë mandatit tonë dhe kemi shqyrtuar shkresa që nuk janë në kompetencë dhe brenda fushëveprimit të Komisionit. Sa i përket kërkesës në fjalë, tha se është domosdoshmëri jo ta interpretojnë, sepse kuorumi është çështje teknike, por pasoja është e madhe, sepse po flasim për dy ligje, pra edhe për Ligjin për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor në lexim të dytë, dhe nëse nuk ka pasur kuorum për të kaluar, atëherë ky është një defekt i madh për demokracinë, sepse po zbatohet diçka që nuk ekziston. Në të njëjtën kohë edhe te Projektligji për tekstet shkollore, që është në lexim të parë, nuk mund të ecet tutje. Deputeti Beqa theksoi se nuk duhet të bëjnë interpretim, por mund të kërkojnë nga Kryesia e Kuvendit, por edhe nga Kryetari, sepse i bëjmë nder institucionit përkatës të Parlamentit, që të japë një sqarim dhe ta vërtetojë për opinionin publik se a ka pasur kuorum apo jo, sepse nuk ka mundësi që këto ligje të zbatohen, derisa të bëhet debat publik se a e kanë marrë votën e deputetëve. Deputeti Beqa potencoi se kjo është një çështje teknike dhe jo politike, por që pasoja është më shumë se politike, sepse prodhon defekte në zbatimin e tyre. Deputeti Beqa shtoi se ne mund t'i ikim kësaj teme, mirëpo edhe sikur vetëm ta kishim dëgjuar në media një qytetar apo një jurist që ka ngritur si shqetësim që një ligji i caktuar i Kuvendit nuk i ka marrë votat dhe po zbatohet, ne është dashur si Komision të ndërmarrim diçka ose të ndodhë ajo që po propozoi deputeti Selmanaj, që të shtyhet dhe të kemi materialin, si dhe të konsultohemi paraprakisht apo t'ia dërgojmë një letër Kryesisë së Kuvendit dhe Kryetarit dhe të kërkojmë sqarim dhe dëshmi për opinionin publik apo për seancë plenare, se a ka pasur kuorum apo jo dhe mendon që kjo çështje duhet të diskutohet edhe në seancë plenare.

Kryetari, tha se ajo që mund të kthejmë në përgjigje, si plotësim, është se neni 61 i Rregullores së Kuvendit, thotë: **Kuorumi dhe votimi në seance plenare të Kuvendit** “1. Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit. 2. Prania e deputetëve në seancë verifikohet me sistem elektronik, me numërim fizik ose me thirrje të emrave. Për mënyrën e verifikimit të pranisë së deputetëve, vendos kryesuesi i seancës. 3. Vendimet e seancës plenare janë të vlefshme, nëse në votim marrin pjesë më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit. Akti i Kuvendit konsiderohet i miratuar nëse për të votojnë shumica e deputetëve që marrin pjesë në votim”. Kryetari tha se kaq kemi për t'iu thënë, ne nuk mund t'i numërojmë votat dhe deputeti në fjalë i ka drejtuar letër edhe Kryesisë dhe Kryesia e ka mandatin e plotë ta autorizojë sekretarin e Kuvendit, të cilin e zgjedh, i raporton dhe merr pjesë në mbledhje të Kryesisë dhe të sjellë raportin e Kryesisë se a kanë qene 60 deputetë apo 61. Në momentin që konstatohet numri i pjesëmarrësve në votim, mbyllet çështja në kuptimin e interpretimit dhe pjesa tjetër pastaj procedura e kontestimit në Gjykatën Kushtetuese.

Driton Selmanaj, tha se neni 122 i Rregullores së Kuvendit thotë: “Interpretimin e Rregullores gjatë seancës plenare e bën kryesuesi i seancës plenare, kurse gjatë mbledhjes së komisionit, kryesuesi i mbledhjes së komisionit. Interpretimi i tillë nuk është objekt kontestimi dhe diskutimi, gjatë seancës plenare ose mbledhjes së komisionit. 2. Deputeti mund t'i drejtohet Komisionit

përkatës për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, për interpretim të Rregullores, nëse konsiderohet që janë shkelur të drejtat nga paragrafi 1 i këtij neni.” Në paragrafin e parë, në seancë plenare, për prezencën e deputeteve apo për kuorumin ka vendosur vetë Kryetari, sepse është në mandatin e tij, por kur një deputet e konteston sjelljen ose vendimin e Kryetarit, atëherë kërkon nga ne nëse është veprim i drejtë apo jo dhe ne patjetër duhet të lëshohemi në këtë çështje, sepse aty ka pasur një vendim të Kryetarit, sepse është kryesues i seancës dhe ka thënë që ka kuorum dhe ai është interpretuesi i fundit, ndërsa tani deputeti po e konteston kuorumin që i bie si rezultat që po e kundërshton edhe vendimmarrjen dhe ne tani duhet të bëhemi palë për ta konstatuar nëse vendimmarrja ka qenë me kuorum apo jo. Në rastin e kundërt, mund të kryejmë një cikël shumë të panevojshëm. Deputeti Selmanaj tha se mund të komunikojmë me administratën dhe të përcjellim kërkesën e deputetit për verifikim të votave. Me nenin 122, ka tërësisht të drejtë në kërkesën e tij dhe ne jemi palë e përfshirë, deshëm apo nuk deshëm.

Kryetari, tha se neni 122 flet për interpretimin e Rregullores së Kuvendit dhe interpretimi minimalisht presupozon që dispozita nuk është e qartë ose janë nxjerrë kuptime të ndryshme, ose është nxjerrë nga Kryetari i Kuvendit kuptim tjetër dhe ka hapësirë për interpretim, sepse kërkesa nuk po kërkon interpretim, por verifikim dhe titulli i kërkesës është për verifikim të votave. Kryetari tha se nuk po e refuzon kërkesën që t’i japë kahe, mirëpo nëse Kryesia e Kuvendit që tashmë e ka kërkesën, vlerëson se Komisioni për Legjislacion duhet të përfshihet në këtë pikë, tha se është dakord që të përfshihemi si komision, mirëpo këtu sheh vetëm një veprim të mundshëm, autorizim i administratës, respektivisht sekretarisë, që t’i numërojë votat dhe kur të verifikohen votat, nuk ka asnjë dilemë pastaj.

Dimal Basha, tha se pajtohet që numërimin e bën administrata në seancë dhe Kryetari deshi apo nuk deshi, i nënshtrohet atij numërimi dhe e bën përcaktimin. Pra, aty nuk është që Kryetari e bën numërimin vetë, por mund të jetë gabim vetëm kur Kryetari konstaton që numrat që i jep administrata. Deputeti Basha, tha se meqenëse shkresa ka shkuar edhe në Kryesi, atëherë Kryesia është i bindur që do të bëjë një kërkesë tek administrata, për të marrë konfirmimin, sepse kërkesa është që të bëhet numërimi i votave, dhe nëse e trajtojmë ne këtë çështjeje, do të duhet të futemi në youtube apo kudo që është e incizuar seanca dhe t’i numërojmë votat, por ne nuk e bëjmë atë. Deputeti Basha theksoi se duhet të presin, meqë shkresa ka shkuar në Kryesi, dhe nëse jo, atëherë do ta trajtojmë vetë këtë çështje, mirëpo nuk e sheh të arsyeshme që ne si Komision, të ulemi para një ekrani dhe të bëjmë numërimin e votave.

Artan Abrashi, gjithashtu tha se nuk e sheh të arsyeshme të bëjmë numërimin e votave nga ekrani dhe shtoi se shkresa ka ardhur në adrese të gabuar, sepse po flitet për një shkresë që ka të bëjë me një çështje teknike dhe pajtohet me deputetin Selmanaj, që në rastet kur ngrihen dyshime të tilla, duhet të ofrohet një adresë, mirëpo mendon që komisioni ynë nuk është adresa. Deputeti Abrashi shtoi se verifikimi në mënyrë teknike dhe elektronike është një çështje që e bën administrata dhe jo Komisioni që merret me interpretimin e Rregullores së Kuvendit. Deputeti Abrashi theksoi se po supozojmë që unë e kam një dyshim lidhur me procesin e votimit ose diçka që ka të bëjë me punën e Kuvendit, kujt i bie barra e provës në këtë rast, vet atij që pretendon që diçka nuk është në rregull dhe shtoi se ajo që dëshiron të thotë, është se parashtuesit e kërkesës, qoftë të kësaj kërkesë apo në të ardhmen, kushdo që ngre kërkesa të tilla, drejtuar këtij komisioni, duhet që të na ofrojë fakte dhe prova bazë, ku dyshimi është i bazuar, përndryshe ne do të lëshohemi në pretendime që edhe ndoshta janë humbje kohe. Deputeti Abrashi tha se në këtë kërkesë nuk po

shih përpos një dyshimi të shkruar se kuorumi nuk paska qenë në rregull, mirëpo a ka mundësi së paku një provë që e bazon këtë dyshim dhe shtoi se kjo shkresë është dashur t'i dërgohet administratës së Kuvendit e pastaj administrata e Kuvendit me Kryesinë ta zgjidhë. Deputeti Abrashi potencoi se Komisioni i ligjeve nuk është i duhuri për ta trajtuar një kërkesë që ka një përmbajtje të tillë.

Kryetari, tha se deputeti Abrashi preku një element shumë të rëndësishëm, ku titulli i kërkesës është verifikim i votimit të dy projektligjeve me kuorum të pamjaftueshëm dhe po të ishte kërkesa ku deputeti i ka verifikuar votat dhe ka kërkuar nga sekretaria që e ka për detyrë numërimin e votave dhe e ka njoftuar Kryetarin për numrin e votave dhe që mund të ketë gabuar dhe ka kërkuar verifikim, ka marrë përgjigje dhe raport dhe po të kishte kërkuar nga Komisioni për Legjislacionin për të konstatuar se mbi këto të dhëna a mund të konsiderohet që është miratuar projektligji, atëherë besoj që do të ishim të përfshirë dhe do t'i thoshim që nuk është miratuar.

Hajdar Beqa, tha se nëse ne zbatojmë ligje që nuk i kanë marrë votat, atëherë i humb kredibiliteti dhe nuk do të jetë më institucion i rëndësishëm. Ne duhet të kemi një përgjigje, si Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe shtoi se deputeti ka pasur të drejtë kur iu ka drejtuar komisionit përkatës, sepse nuk ka komision tjetër, jo për të numëruar votat. Ne mundemi që me një shkresë drejtuar Kryesisë, që të autorizojë Kryetari administratën, që të konstatohet se a ka pasur kuorum apo jo. Deputeti Beqa theksoi se si do të mbajmë seancë tjetër, kur dikush po na i konteston dy ligje prej seancës paraprake, kushdo qoftë ai, një gazetar, një qytetar, një jurist apo një profesor të thotë se nuk e kemi kaluar ligjin, i ka marrë 60 vota. Deputeti Beqa tha se e mbështet atë që tha deputeti Selmanaj, që këtë pikë ta shtyjmë për mbledhjen e radhës dhe nëse deri atëherë nuk ka përgjigje nga Kryesia, atëherë e trajtojmë si Komision, sepse është në interes të Kuvendit.

Kryetari, tha se nuk paraqet problem shtyrja e pikës, por është problem që mund të vijmë prapë në situatën e njëjtë, sepse unë besoj që Kryesia do ta trajtojë këtë, sepse askush nuk ka tendencë që të ecë tutje me projektligje të miratuara pa kuorum, ndërkohë që këtu ka edhe mekanizma të tjerë të kontestimit, ku deputetët mund ta kontestojnë në Gjykatë Kushtetuese, vetëm procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të një ligji në Kuvend të Kosovës, në kuptimin e kuorumit. Kryetari theksoi se këtu është në pyetje verifikimi teknik i deputetëve votues në seancë dhe këtë duhet ta bëjë Sekretaria e Kuvendit, siç e ka bërë në momentin e votimit dhe e ka njoftuar Kryetarin, ashtu duhet ta bëjë edhe në rast të kontestimit nëpërmjet mjeteve që ka në dispozicion dhe në momentin që e konstaton administrata, mbase edhe bashkë me deputetin, që nuk kanë qenë 61 deputetë, por 60 deputetë, duhet të komunikojmë me atë, i cili ka konstatuar që ka pasur kuorum, kur është votuar e që është Kryetari i Kuvendit. Kryetari tha se ky është qëndrimi i tij dhe nëse ka ndonjë zhvillim apo një informate tjetër në kuptimin që e sqaron në rregull, por në të kundërtën, tha se nuk mund ta sjellë më në Komision.

Driton Selmanaj, tha se duhet të presim, meqë edhe kryetari po insiston që të presim përgjigjen e Kryesisë, mirëpo pavarësisht edhe nëse nuk ka përgjigje nga Kryesia, kryetari i Komisionit duhet të marrë votën e deputetëve të Komisionit për Legjislacionin, për të kthyer përgjigje në kërkesën e deputetit Korenica. Po ashtu, tha se nuk është çështje tërësisht teknike, teknike janë votat, por kuorumi dhe vendimmarrja pastaj dalin me pasoja, ku preket mandati kryesor i deputetit dhe i Kuvendit të Kosovës. Ndërkohë, theksoi se është tjetër çështje mënyra sesi e ka shkruar deputeti kërkesën dhe ka mundur ta shkruajë: “A vlerësoni ju, si Komision, që me 60 vota mund të

miratohet një ligj, sepse unë kam argumentin që nuk kanë qenë më shumë” dhe në atë rast do të duhej ta trajtonim dhe t’i drejtohem administratës, që administrata ta verifikojë sa vota kanë qenë. Deputeti Selmanaj potencoi se nuk është çështje e jona që ne t’i numërojmë votat. Më tej, tha se e unë i besoj kësaj administrate dhe këtyre kamerave, edhe pse nuk po arrij ta kuptoj kurrë çka është duke ndodhur me sistemin elektronik të Kuvendit dhe po duket nganjëherë sikur të jetë e qëllimshme, por gjithsesi është më mirë të presim përgjigjen e Kryesisë, nëse jo në mbledhjen e radhës, e trajtojmë edhe përgjigjen dhe të kemi kohë që ne vet t’u kthehemi procesverbaleve dhe transkriptove, se çfarë është diskutuar në atë seance dhe t’i analizojmë.

Kryetari, tha se është në rregull që të presim se çfarë vendos Kryesia, dhe nëse eventualisht ka zhvillime nga Kryesia, atëherë e bën të panevojshme dhe shtoi se nuk ka dilema mbi argumentet për këtë gjë dhe është i gatshëm që të orientojë deputetin dhe këdo për t’i realizuar të drejtat e tij ose saj, madje edhe në rastin kur preken drejtpërdrejt. Kryetari theksoi se nuk mendon që është mirë që Komisioni për Legjislacion të lëshohet në procese teknike dhe të hapë derën rasteve dhe të krijojë precedent të rasteve të tilla.

Meqë nuk pati ndonjë çështje tjetër, u dakorduan të presin se çfarë do të vendosë Kryesia e Kuvendit, lidhur me këtë pikë.

8. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati ndonjë çështje tjetër për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Adnan Rrustemi,
Kryetar i Komisionit
